



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 176, datë 01.12.2023

**PËR NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 475, DATË 23.12.2017 “PËR MIRATIMIN E
SISTEMIT TË RI TË ADRESAVE TË BASHKISË DURRËS”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” i ndryshuar, Ligjit nr.114/2015, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 475 datë 23.12.2017 “Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e emërimit të rrugës “Fatos Tartari” me vendndodhje në Lagjen nr.10, Njësia Administrative Nr.2, sipas planvendosjes bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Ndërmarrja Rruga, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.


KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 04.12.2023

Google Maps



Të dhënat e Hartës ©2023 10 m






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 766 prot.
4

Durrës, më 13.12.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.176 datë 01.12.2023 “Për një shtesë në VKB-NË nr.475, datë 23.12.2017,”Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

